

# Lenda: Permbledhje per kerkese leje mjedisi Tipi B

## Drejtuar: AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Emri i Kërkuesit:

- a) Person juridik  
Kompania; **“TUNAMAR” SHPK**  
Emri tregtar: **“TUNAMAR” SHPK**  
Nr. NIPTI: **L42610208C**  
Adresa: **Elbasan Bradashesh KUSARTH Fshati Kusarth, rruga Kadri Hoxha, zona kadastrale 2346, pasuria nr.428/5/4.**

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar) “Veprimtari te tjera qe perfshijne perdorimin e solventeve”
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar) “ Veprimtari te tjera qe perfshijne perdorimin e solventeve ID 7.12 i. Veprimtari te tjera te lyerjes veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve (me perjashtim te stampimit/Printimit me makine shtypi relative), pelhurave, filmit dhe letres.
3. Vendndodhja: Qarku Elbasan, Bashkia Elbasan, Njesia administrative Bradashesh, Fshati Kusarth

Emri, titulli i personit të autorizuar: **Z. Zamir DURBAKU (Administrator)**

( Firma, Vula)

Tarifa e paguar në datë **01/04/2019 (Ne vleren 30.000 leke)**

- për kërkesë për leje mjedisi tipi B  
 ndryshim të kushteve të lejes

## 1 INFORMACION MBI KËRKUESIN/OPERATORIN

### 1.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Emri i Kompanisë	<b>“TUNAMAR” SHPK</b>
Statusi Ligjor	<b>SHPK, AKTIV</b>
Ortaket/Aksionerët e Kompanisë(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR)	<b>Zamir DURBAKU Pjesëmarrja në përqindje (100%)</b>
Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë	<b>Elbasan Bradashesh KUSARTH Fshati Kusarth, rruga Kadri Hoxha, zona kadastrale 2346, pasuria nr.428/5/4.</b>
Adresa postale e Kompanisë, nqse ndryshon nga adresa e mësipërme	<b>NUK NDRYSHON</b>

## Aplikim leje Mjedisit Tipi B

Numri i regjistrimit të Kompanisë(NIPT)	<b>L42610208C</b>
Kodi kryesor i aktivitetit (sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr 10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit”)	<b>Veprimtari te tjera qe perfshijne perdorimin e solventeve ID 7.12 i</b>
Kodi SNAP <sup>1</sup>	
Kodi NOSE-P <sup>2</sup>	
Numri i Punonjësve	<b>8 PUNONJES</b>
Përfaqësuesi i autorizuar	<b>Zamir DURBAKU</b>
Emri dhe Mbiemri	<b>Zamir DURBAKU</b>
Pozicioni në Kompani	<b>ADMINISTRATOR</b>
Telefoni	<b>+355 69 20 43 271</b>
Faksi	<b>SKA</b>
E-mail	<b>tunamar.peshore@gmail.com</b>

### 1.2 INFORMACION MBI INSTALIMIN/IMPIANTIN

Emri i instalimit/impianitit <sup>3</sup>	<b>“ Veprimtari te tjera qe perfshijne perdorimin e solventeve, ID 7.12 i. Veprimtari te tjera te lyerjes veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve (me perjashtim te stampimit/Printimit me makine shtypi relative), pelhurave, filmit dhe letres”.</b>															
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	<b>Elbasan Bradashesh KUSARTH Fshati Kusarth, rruga Kadri Hoxha, zona kadastrale 2346, pasuria nr.428/5/4.</b>															
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Nr. Pikash (ST)</th> <th style="text-align: left;">X-Lindje</th> <th style="text-align: left;">Y-Veri</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>ST_1</td> <td>4420460.787</td> <td>4553323.403</td> </tr> <tr> <td>ST_2</td> <td>4420471.224</td> <td>4553327.302</td> </tr> <tr> <td>ST_3</td> <td>4420469.713</td> <td>4553295.014</td> </tr> <tr> <td>ST_4</td> <td>4420480.976</td> <td>4553298.764</td> </tr> </tbody> </table>	Nr. Pikash (ST)	X-Lindje	Y-Veri	ST_1	4420460.787	4553323.403	ST_2	4420471.224	4553327.302	ST_3	4420469.713	4553295.014	ST_4	4420480.976	4553298.764
Nr. Pikash (ST)	X-Lindje	Y-Veri														
ST_1	4420460.787	4553323.403														
ST_2	4420471.224	4553327.302														
ST_3	4420469.713	4553295.014														
ST_4	4420480.976	4553298.764														
Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisit <sup>4</sup>	<b>ID 7.12 i. Veprimtari te tjera te lyerjes veshjes perfshire ato te metalit, plastikes, tekstileve (me perjashtim te stampimit/Printimit me makine shtypi</b>															

<sup>1</sup> Nomenklatura e zgjedhur për burimet e ndotjes së ajrit, të specifikuar në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisit për kërkuesit

<sup>2</sup> Nomenklatura për burimet e shkarkimit, të specifikuar në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisit për kërkuesit

<sup>3</sup> Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

<sup>4</sup> Shkruani kodet e specifikuar në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

## Aplikim leje Mjedisii Tipi B

	relative), pelhurave, filmit dhe letres”.
Kapaciteti i projektuar	<b>20 Peshore ne Vit</b>

Tabela në vijim përfshin listën e të gjithë lejeve, liçensave, autorizimeve të përfutuara në datën e dorëzimit të Formularit të kërkesës.

Leja, Liçensa, Autorizimi	Nr. Ref.	Data e Lëshimit	Periudha e vlefshmërisë
<b>Autorizim per Riparim, Verifikim dhe Vulosje te perkohshme te instrumentave mates ligjerisht te kontrolluara</b>	<b>NR. 1972/8 PROT VENDIM ADMINISTRATIV NR. 2 DATE 31/08/2017</b>	<b>DATE 31/08/2017</b>	<b>NGA 31/08/2017 DERI 31/08/2020</b>
<b>Çertifikate Pronesie</b>	<b>Zona Kadastrale : Nr. 2346 Toke Are Nr. 428/5/7 5 / 153 390.0 m<sup>2</sup></b>	<b>DATE 12/01/2019</b>	<b>PA AFAT</b>
<b>Çertifikate Pronesie</b>	<b>Zona Kadastrale : Nr. 2346 Toke Are Nr. 428/5/4 5 / 110 1,400.0 m<sup>2</sup> 500.0 m<sup>2</sup> 301.0 m<sup>2</sup></b>	<b>DATE 12/01/2019</b>	<b>PA AFAT</b>

Duhet të përfshihen të gjitha lejet, liçensat, autorizimet e vlefshme në datën e dorëzimit të kërkesës.

### 1.3. INFORMACIONI MBI PERSONIN E KONTAKTIT TË AUTORIZUAR NGA ADMINISTRATORI NË LIDHJE ME LEJEN

Emri dhe Mbiemri	<b>Zamir DURBAKU</b>
Adresa	<b>Lgj. Aqif Pasha Rr. Rinia Elbasan</b>
Pozicioni në kompani	<b>ADMINISTRATOR</b>
Telefoni	<b>+355 69 20 43 271</b>
Faksi	<b>SKA</b>
E-mail	<b>tunamar.peshore@gmail.com</b>

## Aplikim leje Mjedis Tipi B

### 1.4. PRONËSIA E TOKËS

Emri/adresa e pronarit/pronarëve të tokës, Numri i identifikimit të pronës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP<sup>5</sup> ku janë ndërmarrë (nqse ndryshojnë nga ato të kërkuarit) apo do të ndërmerren aktivitetet (nqse ndryshojnë nga ato të kërkuarit)

Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve	<b>"TUNAMAR" SHPK</b>
Të dhëna për pronësinë e tokës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP	<b>1- Prona : Toke Are Nr. Pasurise : Nr. 428/5/7 Volum / Faqe 5 / 153 Siperfaqe Totale m<sup>2</sup>: 390.0</b> <b>2- Prona: Are + Truall dhe Ndertese Nr. Pasurise : Nr. 428/5/4 Volum / Faqe 5 / 110 Siperfaqe Totale m<sup>2</sup>: 1,400.0 Siperfaqe Trualli m<sup>2</sup>: 500.0 Siperfaqe Ndertese m<sup>2</sup>: 301.0 Totali m<sup>2</sup>:</b> <b>Siperfaqe Totale m<sup>2</sup> 1,790.0</b> <b>Siperfaqe Trualli m<sup>2</sup> 500.0</b> <b>Siperfaqe Ndertese m<sup>2</sup> 301.0</b>
Adresa	<b>Elbasan Bradashesh KUSARTH Fshati Kusarth, rruga Kadri Hoxha, zona kadastrale 2346, pasuria nr.428/5/4.</b>
Informacion për kontratën e qerasë nëse ka Nr. i kontratës së qerasë nëse kërkuar nuk është pronar i tokës deri në këtë moment	<b>NUK KA KONTRATE QERAJE</b>

### 1.5. PRONËSIA E IMPIANTIT

Emri dhe adresa e pronarit të impiantit ku kryhet aktiviteti, si dhe informacion mbi kontratën e qerasë nëqoftëse kërkuar nuk është pronari i impiantit.

Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve	<b>"TUNAMAR" SHPK</b>
Adresa	<b>Elbasan Bradashesh KUSARTH Fshati Kusarth, rruga Kadri Hoxha, zona kadastrale 2346, pasuria nr.428/5/4.</b>
Informacion mbi kontratën (qeradhënësi dhe qeramarrësi, afati i kontratës, mënyrat e përfundimit të kontratës; periudha e vlefshmërisë) Bashkëngjisni një kopje të kontratës së qerasë	<b>NUK KA KONTRATE QERAJE</b>

<sup>5</sup> Zyra e Regjistrimit të pasurive të paluajtshme

### 1.6.

#### PLIKIMI I BËRË PËR:<sup>6</sup>

Shënoni ✓ në kutinë përkatëse

- Impiante dhe instalime të reja
- Impiante dhe instalime ekzistuese
- Ndryshim i konsiderueshëm në impiantet dhe/ose instalimet ekzistuese
- Ndërprerje të aktiviteteve

Në shtojcën 1.2 duhet të paraqisni një ekstrakt nga dokumentet e planifikimit/projektit për instalimin/impiantin e ri, që ka të bëjnë me zonën në fjalë, në mënyrë që të vlerësohen efektet kumulative të pritshme ose ndikimet negative në aktivitetet e ardhshme. Në ekstrakt të përfshihet edhe një legjendë që shpjegon qëllimin e synuar për zonën në fjalë si dhe qëllimin për një zonë më të gjerë zhvillimi.

## 2. Përmbledhje e Përgjithshme

**Zona Kadastrale :** Nr. 2346

**Indeksi i Hartes :** K - 34 - 101 (162 - D)

**Adresa :** Kusarth, Elbasan

### 1. Vendndodhja

Pronat Nr. 428/5/7 dhe 428/5/4 ne vleresim me status pronesie Toke Are & Are + Truall dhe Ndertese, objekt i ketij vleresimi ndodhen ne fshatin Kusarth, ne rrethin e Elbasanit.

Pronat pozicionohen ne nje distance ajrore rreth 2.3 km ne perendim te qendres se qytetit te Elbasanit, referuar Bashkiese dhe Parkut "Aqif Pasha".

Ne terren, pronat ndodhen rreth 2.2 km ne vije ajrore ne lindje te rrethrotullimit te Bradasheshit dhe rreth 1.0 km ne jug-lindje te Fabrikes se Cimentos Elbasan.

Pronat lokalizohen ne anen jugore te rruges kryesore "Kadri Hoxha", ne nje largesi rreth 90 m nga kryqezimi i saj me rrugen qe te con ne prona.

Rreth 200 m ne anen perendimore te pronave eshte i pozicionuar fshati Kusarth ndersa rreth 450 m ne jug-lindje ndodhet Fabrika e Miellit Skraqi.

Zona perreth pronave karakterizohet nga objekte te karakterit komercial dhe rezidencial.

Nje pjese e ndertimeve industriale te zones jane rikonstruktuar vitet e fundit dhe jane vene ne shfrytezim per qellime komerciale

---

<sup>6</sup> Kjo kërkesë nuk i referohet transferimit të lejes në rast të ndryshimit të pronësisë

## *Aplikim leje Mjedisi Tipi B*

---

Ndertimet e zones jane kryesisht shtepi banimi 1-3 kate, magazina dhe kapanone industriale 1-2 kat.

Infrastruktura rrugore e zones eshte sistemuar dhe paraqitet ne gjendje te mire teknike.

Kufizimet e prones ne vleresim jane :

Ne veri : me toke te lire

Ne lindje : me rrugen dytesore qe te con ne prone

Ne jug : me rruge dytesore

Ne perendim : me toke te lire

**Pozicioni gjeografik i pronave referuar fotografimit ajror**



**Koordinatat Gaus Kruger per vendodhjen e Objektit:**

<b><u>Nr. Pikash (ST)</u></b>	<b>X-Lindje</b>	<b>Y-Veri</b>
<b>ST_1</b>	<b>4420460.787</b>	<b>4553323.403</b>
<b>ST_2</b>	<b>4420471.224</b>	<b>4553327.302</b>

## *Aplikim leje Mjedisi Tipi B*

---

<b>ST_3</b>	<b>4420469.713</b>	<b>4553295.014</b>
<b>ST_4</b>	<b>4420480.976</b>	<b>4553298.764</b>

### **Pershkrim i Detajuar i Pronave**

#### **a. Pamja e jashtme**

Pronat perfaqesojne nje Objekt industrial 1 kat me shfrytezim "Fabrike e Prodhimit te Peshoreve Elektronike te Tonazhit te Rende"

si dhe nje seksion 2 kat me shfrytezim ambiente zyra + ambiente ndihmese.

Pasuria Nr. 428/5/7 perfaqesonte sheshin e lire ne anen perendimore te nderteses nr. 428/5/4.

Keto dy prona jane te perfshira brenda te njejtir rrethim dhe funksiononin se bashku.

Pronat pavaresisht shfrytezimit se bashku ne terren mund te ndahen dhe te funksionojne normalisht te pavarura, me akses te vetin per secilen prone.

#### **b. Pamja e brendshme**

Nga inspektimi i kryer u konstatua se pronat Toke Are & Are + Truall dhe Ndertese objekt te ketij raporti vleresimi ishin te strukturuara si me poshte :

1. Hyrja ne prone, Rrethimi dhe Sistemimi i Sheshit te Lire (Pasuria Nr. 428/5/4, 428/5/7)

2. Ndertesa 1 Kat Nr. 428/5/4, Sip. gjurme ndertimi = 301.0 m<sup>2</sup>

2-a. Seksioni 1 Kat, Fabrike H=8.0 m, Sip. = 253.0 m<sup>2</sup>

2-b. Seksioni 2 Kat - Kati Perdhe, Ambiente Ndhmese, Sip. = 48.0 m<sup>2</sup>

2-c. Seksioni 2 Kat - Kati i Pare, Ambiente Sherbimi + Ndhmese, Sip. = 63.0 m<sup>2</sup>

#### **1. Hyrja ne prone, Rrethimi dhe Sistemimi i Sheshit te Lire (Pasuria Nr. 428/5/4, 428/5/7)**

**Aksesi** per ne prona, realizohet ne kufirin lindor te tyre drejtperdrejte nga rruga dytesore, e cila kishte dalje ne rrugen kryesore "Kadri Hoxha", ne anen veriore.

**Porta hyrese** ne prone eshte dere metalike industriale me hapje automatike, e pajisur me rrjete teli me hoje.

**Rrethimi** i pronave ne terren eshte realizuar ne te kater anest e saj njelloj. Rrethimi eshte realizuar me rrjete teli te fiksuar ne profile metalike dhe te mbeshtetur ne nje brez betonarme me lartesi rreth 30 cm.

Themeli i rrethimit ishte prej betoni ndersa lartesia e tij shkon rreth 2.5 - 3.0 m.

## *Aplikim leje Mjedisi Tipi B*

---

**Sheshi i lire** perreth pronave ne vleresim eshte i sistemuar ne menyre cilesore Sheshi ne te gjitha anet e tij eshte shtruar me cakull te imet dhe ishte ngjeshur me rrul per kompaktesimin e tij.

Ne perimeter te rrethimit jane mbjelle peme dekorative dhe eishte realizuar terren i pjerret ne pjesen ku rruga eshte ne kuote me te larte.

**Kullimi i ujerave** siperfaqesore behej nga filtrimi natyral i terrenit si dhe nga pjerresite qe ka terreni.

**Ndricimi** i sheshit te lire realizohej nepermjet prozhektoreve te montuar ne paretet e nderteses.

### **2. Ndertesa 1 Kat Nr. 428/5/4, Sip. gjurme ndertimi = 301.0 m<sup>2</sup>**

Mbi siperfaqen e Truallit nr. pasurie 428/5/4, objekt vleresimi, eshte ndertuar objekti industrial 1-2 kat (shfrytezim Fabrike + ambiente sherbimi e ndihmese).

**Viti i ndertimit.** Objekti 1-2 Kat me shfrytezim Fabrike per prodhimin e peshoreve elektronike te tonazhit te rende + ambiente ndihmese, eshte realizuar rreth viteve 2010.

**Konfiguracioni.** Objekti kishte nje konfiguracion te rregullt gjeometrik ne forme drejtekendeshi me permasa rreth 24.3 x 12.4 m.

**Arkitektura.** Arkitektura e objektit ishte e thjeshte, karakteristike e ndertimeve te tilla komerciale, e pershtatur ne funksion te destinacionit te shfrytezimit te saj.

**Fasadat** e nderteses jane te realizuara me veshje me panele sanduic.

Ne paretet e nderteses jane instaluar kamera sigurie per vezhgimin ne ambientin e jashtem dhe sheshin perpara objektit.

**Konstruksioni** i nderteses eshte skelet metalik, me themele plinta beton arme dhe brez betonarme mbi te cilet jane fiksuar kollonat metalike

Brezi betonarme dhe qafa e plintave b/arme vazhdon deri ne kuoten +0.50 m nga niveli i tokes, ku me pas behet instalimi dhe fiksimi i konstruksionit metalik.

**Mbulimi i nderteses** eishte realizuar me konstruksion metalik mbi te cilen jane vendosur panele sanduic dhe elemente plastike per te siguruar ndricimin e ambienteve te brendshme.

**Muret perimetrale** jasne veshur me panele sanduic sikurse mbulesa e nderteses.

Ndricimi kryesor i nderteses realizohet nga catia nepermjet hapësirave te mbuluar me plastike pikerisht per kete qellim, si dhe nepermjet dritareve duralumin te lena ne kati e pare te seksionit 2 kat.



*Organizimi i ndertesës ishte ne dy seksione (ne varesi te nr. te kateve), duke j'u pershtatur edhe funksionit te secilit prej tyre, perkatesisht :*

### **2-a. Seksioni 1 Kat, Fabrike H=8.0 m, Sip. = 253.0 m<sup>2</sup>**

**Seksioni 1 Kat** perbente pjesen lindore te objektit ne vleresim dhe shfrytëzohej si Fabrike per prodhimin e peshoreve elektronike te tonazhit te rende.

**Aksesi** per ne ambientet e brendshme te ketij seksioni ishte pozicionuar ne fasaden lindore te ndertesës.

**Portat kryesore hyrese** ishin qepena metalike me hapësira drite rreth 4.0 m dhe lartesi rreth 4.5 -5.0 m.

**Muret perimetrale** te ketij ambienti ishin realizuar me panele sanduic.

**Dyshemeja** e ambienteve te brendshme ishte e shtruar me beton te armuar, te niveluar dhe te nje cilesie te mire per perballimin e ngarkesave.

**Ndricimi natyral** realizohej nepermjet hapësirave te drites te lena ne cati per kete qellim.

**Mbulesa** ishte e realizuar me panele sanduic dhe material plastik per ndricim.

**Ndricimi artificial** realizohej nepermjet prozhektoreve te varur ne tavan.

### **2-b. Seksioni 2 Kat - Kati Perdhe, Ambiente Ndhimese, Sip. = 48.0 m<sup>2</sup>**

**Seksioni 2 Kat** perbente pjesen perendimore te objektit ne vleresim dhe shfrytëzohej si ambient sherbimi dhe ambiente ndhimese per aktivitetin e zhvilluar ne prone.

**Konstruksioni** i ketij seksioni ishte realizuar me skelet metalik te veshur me gips ne muret anesore dhe tavan.

**Aksesi** per ne kati perdhe te ketij seksioni realizohej drejteperdrejte nga ambientet e brendshme te fabrikes.

**Portat kryesore hyrese** ne ambientet e brendshme te katit perdhe ishin duralumin.

**Organizimi.** Kati perdhe i seksionit 2 kat ishte organizuar ne nje ambient tualeti, nje ambient gatimngrenie, zyre dhe magazine.

## *Aplikim leje Mjedisi Tipi B*

---

**Muret perimetrale dhe ndares** te ambienteve ishin realizuar me gips, patinuar dhe lyer me boje.

**Dyshemeja** e ambienteve te brendshme ishte e shtruar me pllaka gres te nje cilesie te mire. Dyshemeja e magazines ishte e shtruar me beton sikurse fabrika.

**Soleta** ishte realizuar me konstruksion metalik dhe veshje me gips ne tavanin e katit perdhe.

**Ndricimi** realizohej nepermjet neoneve te fiksuar ne tavan.

**Rifiniturat** e brendshme ishin te reja dhe te nje cilesie te mire.

### **2-c. Seksioni 2 Kat - Kati i Pare, Ambiente Sherbimi + Ndhimese, Sip. = 63.0 m<sup>2</sup>**

**Aksesi** per ne katin e pare teknik te seksionit 2 kat realizohej drejteperdrejte nga ambientet e brendshme te fabrikes nepermjet shkalleve metalike.

**Organizimi.** Kati i pare teknik i seksionit 2 kat ishte organizuar ne nje ambient magazinimi, korridor dhe 3 ambiente zyresh.

**Muret perimetrale dhe ndares** te ambienteve ishin realizuar me gips, patinuar dhe lyer me boje.

**Dyshemeja** e ambienteve te brendshme ishte e shtruar me parket laminat te nje cilesie te mire. Dyshemeja e magazines ishte e shtruar llamarine.

**Tavani** i katit te pare te seksionit 2 kat ishte veshur me gips, patinuar dhe lyer me boje.

**Ndricimi** realizohej nepermjet abazhureve te fiksuar ne tavan dhe dritareve duralumin.

**Dritaret** ishin vendosur ne pjesen qendrore te zyrave dhe ishin duralumin cilesore.

### **Instalimet Hidraulike dhe Elektrike**

Instalimet hidraulike dhe elektrike ne objekt ishin kryer dhe funksiononin normalisht.

### **Informacion rreth ndotjes reale ose te mundshme**

Bazuar ne informacionet e disponuara rezulton se zona ku ndodhet prona nuk ben pjese ne zonat e ndotura ekologjiksht.

Gjithashtu ne terren nuk eshte konstatuar ndonje faktor i cili te shprehte potencial te mundshem te ndotjes ekologjike te zones.

## Aplikim leje Mjedis Tipi B

---

### Infrastruktura Elektrike

Furnizimi me energji elektrike te zones behet nepermjet infrastruktures me kablllo ajrore te lidhura me nenstacionin elektrik me te afert.

Prona eshte e lidhur me rrjetin e energjise elektrike me kabinen me te afert elektrike.

### Infrastruktura Hidrosanitare

Furnizimi me uje te pijshem realizohet me ane te tubacioneve shperndarese te rrjetit te ujesjellesit te zones.

Shkarkimi i ujerave te zeza behet pjeserisht ne gropa septike te cilat jane ndertuar privatisht prane ndertesave individuale.

### 1.7 INFORMACION INFORMACION NË LIDHJE ME NDRYSHIME TË KONSIDERUESHME TE PROPOZUARA TE LEJES SË TIPIT B PER NJE INSTALIM/IMPIANT EKZISTUES

Operatori/kërkuesi plotëson tabelën e mëposhtme vetëm kur kërkon ndryshime të kushteve të lejes së mjedisit të Tipit B, për një instalim/impiant ekzistues.

Emri i impiantit (sipas lejes ekzistuese të mjedisit)	Aplikim I ri
Data e dorëzimit të kërkesës për ndryshime të lejes së lëshuar të mjedisit të Tipit B	Aplikim I ri
Data dhe numri i lejes ekzistuese të mjedisit, të Tipit B, (refero <b>Nr.e identifikimit të Lejes sipas Regjistrit të AKM</b> )	Aplikim I ri
Vendodhja e impiantit/ instalimit (qarku/ bashkia/komuna, numri kadastral)	Aplikim I ri
Arsyeja/arsyet për ndryshimin e kërkuar në lejen e mjedisit	Aplikim I ri